

FJALA E DEPUTETIT SALI BERISHA

E HËNË 6 QERSHOR 2022

Së pari, denoncoj qeverinë, e cila nuk sjell në parlament marrëveshjet e ekstradimit me vendet e Beneluksit, dhe këtë nuk e bën për faktin e vetëm se të paktën gjashtë ministra dhe shumë e shumë deputetë të tjerë socialistë janë kandidatë për ekstradime. Së dyti, kam një pyetje për parafolësin që s'dua t'ia përmend as emrin: sa i pagove Nuredin Dumanit për të të shpëlarë te Manhasët. Kjo do të dalë, por nuk është vetëm kjo. Ja ku po jua them, të nderuara zonja, ai ka mbi 50 apo 100 telefonata me Dumanin, me sharrën, me gozhdën dhe me serialin e bandës së Suel Çelës, Talo Çelës e të tjerë me radhë. Pra, këto janë.

Tani kthehem te çështja, për të cilën kam dalë të flas. Shqipëria e Edi Ramës, vendi i monizmit total, republika moniste e Xhorxh Sorosit në Europë! E shtuna e 4 qershorit të vitit 2022 do të gdhendet në memorien e kohës si një ndër ditët më të zeza në historinë e demokracisë shqiptare. Ajo ishte dita e funeralit të sistemit demokratik në Shqipëri. Me uzurpimin me votat e rrëmbyera të shqiptarëve të institucionit të fundit shtetëror, që kishte mbetur jashtë kontrollit të Partisë Socialiste, e institucionit të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, në vend u rivendos sistemi monist i plotë dhe u varros sistemi i bazuar në ndarjen dhe balancën e pushteteve të garantuara me Kushtetutë. Me emërimin më 4 qershor nga pseudomaxhoranca të gjeneral Bajram Begajt President i Republikës, sot në Shqipëri, njëlloj si dikur në diktaturën hoxhiste, të gjitha pushtet janë në dorën e një partie dhe të një njeriu.

Sot, si asnjëherë më parë në tridhjetë e një vite, në pushtetin ekzekutiv, çdo ministër, zëvendësministër, çdo drejtor dhe sekretar i Përgjithshëm është vetëm i një partie, i Partisë Socialiste. Sot, njëlloj si në të shkuarën tonë moniste, të gjitha institucionet e larta shtetërore, të konsideruara si të pavarura apo autonome, si ai i Presidentit, Kontrollit të Lartë të Shtetit, Drejtorit të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe atij të Ushtrisë, Inspektorit të Lartë të Deklarimit të Pasurive, Komisionerit të të Dhënave Private, kryetarët e bordeve të konkurrencës, të

energjisë, bordeve rregullatore të Energjisë e të Telekomunikacionit, janë të gjitha të Partisë Socialiste.

Sot në narkoshtetin shqiptar të gjithë drejtuesit e institucioneve më të larta të drejtësisë, KLGJ-së, ILD-së, KLP-së, KPK-së, KLAP-së, Prokurorisë së Përgjithshme dhe SPAK-ut, çdo gjykatës i Gjykatës së Lartë dhe çdo gjykatës i Gjykatës Kushtetuese, që nuk i ka mbaruar mandati, dhe i tillë është vetëm një, është përzgjedhur dhe është emëruar nga maxhoranca e Partisë Socialiste. Kurrë ndonjëherë, që nga diktatura e Enver Hoxhës, nuk ka ekzistuar një kontroll i tillë total njëpartiak mbi drejtësinë. Sot në Shqipërinë moniste të gjitha organizatat joqeveritare, përveç asaj të zotit Altin Goxhaj dhe dy-tre të tjerave, kontrollohen totalisht nga qeveria dhe kumbari i saj Xhorxh Soros. Sot të gjitha mediet e mëdha dhe ato të vogla, me përjashtim tepër të rrallë të ndonjë medie të vogël, kontrollohen nga narkoqeveria e Edi Ramës.

Ato janë në garë se si të përulen më shumë dhe t'i dezinformojnë qytetarët shqiptarë, përndryshe nuk mbijetojnë. Sot në Shqipëri të gjithë sektorët madhorë jetikë të ekonomisë së vendit zotërohen nga oligarkët e Ramës. Data 4 qershor 2022 shënon zhdukjen përfundimtare të çdolloj kontrolli të pushteteve, me abuzimet e tyre me qytetarët, publikun, interesat e vendit, kusht vendimtar për ushtrimin e tyre në mënyrë kushtetuese dhe demokratike. Me zgjedhjen dy ditë më parë të Presidentit socialist nga maxhoranca socialiste u zhduk përfundimisht dhe gjurma e fundit e balancës midis pushteteve, kusht vendimtar për të mos pasur një pushtet monist, antidemokratik dhe antikushtetues. Natyrisht, kjo mynxyrë e vërtetë për demokracinë shqiptare nuk erdhi brenda një dite apo brenda një viti.

Monizmin në Shqipëri Edi Rama e rivendosi, së pari, për mentalitetin monist, që trashëgon nga etërit e tij bllokmenë e hoxhistë për pushtet njëpartiak. Së dyti, për vendosjen e monizmit total, ai përdori frikën, terrorin, dhunën shtetërore, bandat, krimin drogën dhe varfërinë, me të cilat nënshtroi njerëzit, bleu e rrëmbeu votat e tyre dhe largoi mbi gjysmë milioni shqiptarë nga Shqipëria. Së treti, me një urrejtje patologjike, ai arriti që me tenderë dhe dosje gjyqësore të blejë dhe të marrë peng drejtuesit e ish-opozitës. Në gjithë këtë proces të zëvendësimit të sistemit kushtetues check and balance me monizmin e plotë, ai pati mbështetjen e fuqishme të mafies së Xhorxh Sorosit, e cila vuri në ombrellën e tij organizatat e shoqërisë civile dhe me

pseudoreformën e drejtësisë vuri në kontroll të plotë të ekzekutivit sistemin e drejtësisë. Ai përlligji me deklarata grabitjen e votës së shqiptarëve dhe me lobimin e tij korruptiv bëri gjithçka për të larguar nga skena politike Sali Berishën, vetëm e vetëm për të ndihmuar Ramën dhe narkoqeverinë e tij.

Të dashur qytetarë e qytetare shqiptarë,

Situata sot është më dramatike se kurrë në këta tridhjetë vite, por zgjidhja është sot më shumë se kurrë në duart tona dhe vetëm në duart tona. Shembja e sistemit të kalbur monist arrihet vetëm me guxim, mobilizim, organizim, nën udhëheqjen e opozitës shqiptare, me një lëvizje të fuqishme shpëtimtare për Shqipërinë. Me këtë rast u bëj thirrje shqiptarëve kudo që janë, në emigracion, diasporë, në vende të lira, që të angazhohen me të gjitha potencialet që kanë, për të shpëtuar dheun e tyre, Shqipërinë, nga narkoshteti monist i Edi Ramës. Asnjë shqiptar nuk duhet të harrojë se Shqipëria sot nuk është republika moniste e Enver Hoxhës, por ajo është republika moniste e Edi Ramës. Ajo sot nuk është Republika moniste e Gorge Orwell - it, por republika moniste e Xhorxh Sorosit.

Gjithashtu, duke përfunduar, unë u bëj thirrje miqve të Shqipërisë, shqiptarëve dhe demokracisë së tyre në Europë dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, por edhe kudo në vende të lira që të ndërpresin menjëherë çdo mbështetje për regjimin monist të Edi Ramës. Ne do të fitojmë.